

**STATUTI**  
**I**  
**SHOQERISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR**  
**„ Your Business“ SH.P.K**

**EMRI, FORMA, BAZA JURIDIKE, SELIA, TERRITORI**

**Neni 1**  
**Themelimi**

Sot më 03 Nentor 2021

Themelohet Shoqëria tregtare **“Your Business”** sh.p.k si shoqëri me përgjegjësi të kufizuar në zbatim të ligjit nr.9901 dt.14.04.2008 “Për tregëtarët dhe Shoqëritë Tregëtare” nga ortaket e meposhtem:

- 1- **Francesco Bongiovanni** madhor, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, me pasaporte nr. YA7617362 , lindur ne Senigallia (AN) Itali, me 25.02.1955 dhe banues ne,Rome, Via Fidenza 15.

Shoqëria e ushtron aktivitetin e saj në përputhje me legjislacionin shqiptar dhe ligjin nr.9901 dt.14.04.2008 “Për tregëtarët dhe Shoqëritë Tregëtare dhe me dispozitat e parashikuara në dokumentat themeluese.

Kjo shoqëri fiton zotesinë për të vepruar pas regjistrimit të saj në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit Tiranë, qëndër e cila pas miratimit të regjistrimit të shoqërisë e pajis atë edhe me NUIS-in përkatës identifikues.

**Neni 2**  
**FORMA DHE EMERTIMI**

2.1 Shoqëria do të ketë formën e shoqërisë me pergjegjesi te kufizuar, për sa kohë asambleja e ortakeve nuk do të marrë një vendim për shndërrimin e saj.

2.2.Emërtimi i shoqërisë është " **“Your Business”**” sh.p.k.

Në të gjitha aktet dhe dokumentet e nxjerra nga shoqëria, emërtimi i shoqërisë do të ndiqet nga fjalët “Shoqëri me Përgjegjësi të Kufizuar” ose inicialet Sh.p.k.



**NENI 3  
BAZA JURIDIKE**

4. Shoqëria krijohet në bazë të legjislacionit të Republikës së Shqipërisë dhe si person juridik, e zhvillon aktivitetin në përputhje me këtë legjislacion dhe me normat e këtij statuti. Ajo e fiton personalitetin juridik pas rregjistrimit në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit.

**NENI 4  
SELIA**

**5.Selia e shoqërisë do të jetë në Tiranë.**  
Ne adresen: Njesia Farke, Selite, Rruga Reli, Nr.1, kati 0, hyrja 2 dhe mund te ndryshojë seline e saj me vendim të ortakeve.

**NENI 5  
OBJEKTI I VEPRIMTARISË**


Objekti i veprimtarisë së shoqërisë do të jetë :

- **Konsulenze e firmave . ndermjetesime, konsulenze marketing e tregtare.Pjesmarrje ne shoqeri te tjera dhe blerje aksione ne shoqeri te tjera.Projektim, modelim, prodhim, implementim dhe testim software. Shitje license software dhe sherbimeve perkatese te lidhura me to. Dhenie me qira e softwareve. Software si sherbim. Sherbime te adoptimit dhe pershtatjes se softwareve. Sherbime suporti dhe mirmbajtje te teknologjise se informacionit. Sherbime te konsulences teknike ne fushen e teknologjise se informacionit dhe aktivitete te tjera te subjekteve private dhe publike. Sherbime trajnimi dhe edukimi ne fushen e teknologjise se informacionit. Sherbime te hostimit te bazave te te dhenave dhe te dhenave perkatese. Shoqeria me pergjegjesi te kufizuar Your Business sh.p.k zbaton te gjitha ligjet dhe aktet nenligjore ne fuqi. Import-Export dhe tregtim, artikuj te ndryshem konfensionesh, kerpi, lini, etj. te perfunduara dhe gjyusem te perfunduara. Sherbime fason. Shitje, Blerje, Qiradhenie, Qiramarrje. Menaxhim Projektesh, Menaxhim Pronash te Paluajtshme. Organizim Eventesh, Trajnime Profesionale, Marketing Digjital, Perfaqesim Pronaresh, Perfaqesim Investitoresh.**  
Kompania gjithashtu mund të kryejnë të gjitha transaksionet tregtare dhe financiare dhe të zbatojë të gjitha nismat që lidhen me arritjen e objektivave sociale, duke përfshirë të gjitha aktivitetet që lidhen me pronën e luajtshme dhe të paluajtshme

Per kryerjen e aktivitetit te shoqerise se mesiperme, per te cilin do te nevojitet leje perkatese, shoqeria eshte e detyruar te pajiset paraprakisht me kete leje nga organi kompetent.

**NENI 6  
KOHËZGJATJA**

7.1 Shoqëria do të zhvillojë aktivitetin e saj për një periudhë të pacaktuar, duke filluar nga data e rregjistrimit në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit, me përjashtim të rastit të mbarimit të saj sipas kushteve të parashikuara në ligj ose me vendim të ortakut të vetëm.



**NENI 7  
TERRITORI**

5.1 Shoqëria e zhvillon aktivitetin si në territorin e Republikës së Shqipërisë ashtu edhe jashtë saj.

Shoqëria mund të krijojë degë (filiale) ose përfaqësi, si në rrethe të ndryshme të Republikës së Shqipërisë ashtu edhe në shtete të tjera, në përputhje me legjislacionin e vendeve përkatëse.

**KAPITULLI III  
AUTORITETI I ORTAKUT, LIBRI I SHOQËRISË, KONFIDENCIALITETI**

**NENI 8  
FUSHA E AUTORITETIT TË ORTAKUT**

8.1 Fusha e autoritetit të ortakut dhe përqindja e fitimeve ose e humbjeve do të kenë si kriter bazë kapitalin e Shoqërisë si dhe kompetencat që gëzon ortakut në marrjen e vendimeve të çdo karakteri, të përcaktuara në këtë statut.

**NENI 9  
LIBRI I SHOQËRISË**

9.1 Për të saktësuar veprimtarinë e vet ekonomike si dhe marrëdhëniet e punës, Shoqëria do të çelë librin e vet i cili do të quhet Libri i Shoqërisë.


**NENI 10  
KONFIDENCIALITETI**

10.1 Ortaket e shoqërisë si dhe personat e tjerë të pranuar në Shoqëri bien dakord që të mos i ekspozojnë asnjë personi të jashtëm informacionet që disponon Shoqëria, kontratat që ajo do të lidhë, çdo lloj materiali, si dhe planet ose qëllimet që ajo ka për të ardhmen e saj.

**NENI 11  
DOKUMENTET E DESTINUARA PËR TË TRETËT**

11.1 Të gjitha aktet dhe dokumentat që nxiren nga Shoqëria dhe janë të destinuara për të tretët, si letrat, faturat, lajmërimet, publikimet e ndryshme etj., duhet të tregojnë lexueshëm emrin e Shoqërisë dhe pas tij fjalët "Shoqëri me Përgjegjësi të Kufizuar" ose inicialet "SH.P.K", si dhe emrin e administratorit.

**NENI 12  
KAPITALI THEMELTAR, KONTRIBUTET, PJESËT DHE TRANSFERIMI  
TYRE**



12.1 Kapitali themeltar i shoqërisë do të jetë , 1000000 leke (nje milion).

12.2 Kapitali themeltar është i ndarë në (një) kuotë me vlerë nominale 1000000 (nje milion) leke

12.3 Ky kapital themeltar i shoqërisë është i zotëruar nga Ortaku i vetem si me poshte

- 2- 1- **Francesco Bongiovanni** madhor, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, me pasaporte nr. YA7617362 , lindur ne Senigallia (AN) Itali, me 25.02.1955 dhe banues ne,Rome, Via Fidenza 15. **Zoterues i 1 (një) kuote me vlerë nominale 1000000 (nje milion) leke e barabrte me 100% te kapitalit te shoqërisë. Ortaku ka të drejtë të drejtë të tjetërsojë, të zmadhojë apo të paksojë kuotat e kapitalit deri në kufinj të percaktuara nga ligji**

Kalimi dhe fitimi i kuotave të shoqërisë do të behët në përputhje me nenet 72- 75 të ligjit Nr. 9901, dt. 14.04.2008 “Për Tregëtarët dhe Shoqëritë Tregëtare”.


12.5 Kapitali fillestar i shoqërisë nuk është paguar.

## Neni 13

### Transferimi i kuotave dhe zmadhimi i kapitalit

- Pjeset e kapitalit themeltar janë lirisht të transferueshme në rrugë trashëgimie, apo ndarje pasurore mes bashkëshortëve.
- Transferimi i pjeseve të kapitalit themeltar si trashigimni ose brenda familjes personave perfitues do ti behet pasi ata te pranojne permbajtjen e statutit te kesaj shoqërie tregtare me gjithë ndryshimet qe ai mund te kete pesuarderi ne momentin qe keto pjese te kapitalit themeltar te behen lehtesisht te transferueshme.
- Ne raste mospranimi, pjeset e kapitalit themeltar mund t transferohen personave te trete qe nuk bejne pjese ne shoqëri vetem me miratimin e ortakeve

Transferimi i kuotave te kapitalit themeltar te secilit ortak themelues, ne persona te tjere jo ortake te shoqërisë do te behet vetem me miratimin e Asamblese se Ortakeve. Ne çdo rast ortaku qe kerkon te largohet nga shoqëria, duhet te respektoje te drejten e parablerjes se kuotave nga ortaket themelues te shoqërisë. Ne rast se kuotat e ortakut themelues jane te tilla qe kane nje çmim tregu te ndryshueshem do te merret si çmim i pranuar çmimi me i larte i shitjes, çmim i konfirmuar me garanci oferte te verifikueshem nga pjesmarresit e Asamblese se shoqërisë. Në rast vdekjeje të ndonje prej ortakëve te shoqërisë trashëgimtarët e tij apo rast ndarje pasurore midis bashkeshortëve, subjektet perfitues sipas ligjit kane të drejtë të vendosin për likuidimin e shumës së kapitalit te shoqërisë ose për vazhdimin e veprimtarisë sipas parashikimeve ne ligj nepermjet trashëgimise dhe pjesmarrjes se trashëgimtareve ligjore ne shoqëri apo bashkepjesmarrjes nga ndarja e pasurise bashkëshortore.



Ortakët e kësaj shoqërie, mund të vendosë të shtojë kapitalin themeltar të shoqërisë në çdo periudhë që e shih të nevojshme. Zmadhimi apo zvogëlimi i kapitalit të shoqërisë do të bëhet sipas parashikimeve të këtij Statuti dhe nenit 81 të Ligjit Nr.9901 datë 14.04.2008 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregëtare".

## ORGANI DREJTUES ASAMBLEJA E PËRGJITHSHME

### NENI 14 *Asambleja e Ortakeve*

Secili aksionar ka të drejtë të marrë pjesë në mbledhjet dhe vendimet e mbledhjes së aksionarëve dhe mund të ketë një numër votash të barabarta me aksionet e kapitalit të zotëruar.


Një anëtar mund të përfaqësohet në një mbledhje të përgjithshme në bazë të një delegimi nga një partner tjetër, bashkëshorti ose personi tjetër i caktuar prej tij, me kusht që të autorizohet nga një prokurë.

Asambleja e ortakeve perbehet nga mbledhja e 100% të kuotave të kapitalit të shoqërisë. Ajo mbledhet me kërkesën e Administratorit. Gjithashtu secili prej ortakeve ka të drejtë t'i paraqesë Administratorit kërkesë me shkrim për mbledhjen e asamblese të përgjithshme duke treguar në të arsyet, objektivat dhe çështjet, për të cilat asambleja duhet të marrë një vendim. Në rast se kërkesa refuzohet, ortaku kanë të drejtë të thërrasë asamblesë dhe të caktojë çështjet e rendit të ditës.

Permbajtja dhe rendi i ditës iu njoftohet ortakeve të pakten 7 dite përpara mbledhjes së Asamblese, në rastin e shoqërisë njoftimi iu bëhet të ditur të gjithë ortakeve themelues. Mbledhja quhet e vlefshme kur me një nga menyrat e përcaktuara në ligj, është bërë njoftimi i ortakeve të shoqërisë (pjesëmarrësve të themeluesve), me konfirmim shkresor duke përcaktuar edhe rendin e ditës së mbledhjes. Në rast se pjesëmarrësit marrin pjesë personalisht ata do të konsiderohen të njoftuar pavarësisht nëse nuk ka konfirmim me shkrim. Pjesëmarrësi në mbledhje mund të jetë vete ose të përfaqësohet nga një tjetër person të caktuar me Prokurë përfaqësimi, duke patur të shprehur objektin e mbledhjes në mbledhjen e Asamblese.

Vendimet e asamblese të cilat merren me shumicë të thjeshtë do të jenë të vlefshme vetëm nëse marrin pjesë ortakët me të drejtë vote, që zotërojnë më shumë se 30 për qind të kuotave. Vendimet të cilat merren me shumicë të kualifikuar do të jenë të vlefshme vetëm nëse janë të pranishëm ortakët që zotërojnë më shumë se gjysmën e numrit total të votave. Do të merren me shumicë të kualifikuar prej  $\frac{3}{4}$  të kuotave pjesëmarrëse vendimet për ndryshimin e statutit, zmadhimin ose zvogëlimin e kapitalit të regjistruar, shpërndarjen e fitimeve, riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë. Të gjitha vendimet e tjera do të merren me shumicë të thjeshtë. Asambleja e Përgjithshme është përgjegjëse për marrjen e vendimeve për shoqërinë për çështjet e mëposhtme:

- a) Përcaktimin e politikave tregëtare të Shoqërisë;



- b) Ndryshimet e statutit;
- c) Emërimin dhe shkarkimin e Administratorëve;
- d) Emërimin dhe shkarkimin e likujduesve dhe eksperteve kontabël të autorizuar;
- e) Përcaktimin e shpërblimeve për personat e përmendur në shkronjat c dhe d, të kësaj pike;
- f) Mbikqyrjen e zbatimit të politikave tregëtare nga administratorët , përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë
- g) Miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë të veprimtarisë ;
- h) Zmadhimin dhe zvogëlimin e kapitalit;
- i) Pjestimin e kuotave dhe anulimin e tyre ;
- j) Përfaqësimin e shoqërisë në gjykatë dhe në procedimet e tjera ndaj administratorëve
- k) Riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë
- l) Krijimin e fondeve, përbërjen, madhësinë, burimet e krijimit, mënyra dhe kushtet e përdorimit.
- m) Çështje të tjera të parashikuara nga ligji.

#### **Neni 15**

##### **Mbledhja e Asamblesë së Përgjithshme**

Asambleja e Përgjithshme mbledhet në mbledhje të zakonshme dhe të jashtëzakonshme.

Mbledhja e zakonshme e Asamblesë së Përgjithshme thirret të paktën një herë në vit ndërsa mbledhjet e jashtëzakonshme bëhen sa herë çmohet e nevojshme nga ortaket.

Asambleja e Përgjithshme thirret nga administratori apo ortaket sipas nenit 84 të ligjit nr.9901 datë 14.04.2008 "Për Tregëtarët dhe Shoqëritë Tregëtare".

#### **NENI 16**

##### **KOMPETENCAT E ASAMBLESE SE ORTAKEVE**


Asambleja e Ortakeve ka për kompetence :

Vendos për ndryshimet në Statutin e Shoqërisë dhe përpilon ose miraton rregulloret për Shoqërinë apo për sektorë të veçante të veprimtarisë.

-Te emeroje apo shkarkoje Administratorin e shoqërisë, pronar ose jo pronar.

-Të jape ose jo pelqimin për caktimin e ekspertit kontabel nga Administratorët e shoqërisë, i cili do të bëjë auditimin e vitit ushtrimor;

-Të informohet në çdo kohë për veprimtarinë e shoqërisë dhe të njihet me llogarinë dhe dokumentacionin e saj ;



- Të vendosë për kryerjen e kontroll-revizionit financiar të shoqërisë me ekspertë të caktuar prej saj ose te kerkuar nga çdo ortak ;
- Te jape ose jo miratimin per marrjen e çdo lloj huaje apo kredie bankare.
- Te jape ose jo miratimin per shtimin e kapitalit apo pakesimin e tij.
- Te vendose per miratimin ose jo te largimit te ortakut ne rast te shitjes se kuotave dhe zevendesimin e tij me nje person tjetër.
- Komptenca te tjera që parashikohen ne ligjin Nr.9901 date 14.04.2008 "Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare"

### **ADMINISTRIMI I SHOQËRISË NENI 17**

#### **ADMINISTRATORI DHE KOMPETENCAT E TIJ**


Kompania mund të administrohet nga administratori i vetëm ose administratorët e shumtë, të cilët mund të jenë persona fizikë të emëruar brenda komunitetit ose jashtë këtij komuniteti. Asambleja e Përgjithshme emëron një person fizik si administrator të shoqërisë për një periudhë 5 vjeçare, me të drejtë rimerimi. Emërimi i administratorit jep efekte ligjore vetëm pas regjistrimit në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit.

Administratori i një shoqërie tregëtare mëmë, nuk mund të emërohen si administrator i kësaj shoqërie.

Administratori të detyrohen të:

- a) kryejnë të gjitha veprimet e administrimit të veprimtarisë tregtare të shoqërisë, duke zbatuar politikat tregëtare, të vendosura nga Asambleja e Përgjithshme;
- b) përfaqësojnë shoqërinë tregtare;
- c) kujdesen për mbajtjen e saktë e të rregullt të dokumenteve dhe të librave kontabël të shoqërisë;
- ç) përgatisin dhe nënshkruajnë bilancin vjetor, bilancin e konsoliduar dhe raportin e ecurisë së veprimtarisë dhe, së bashku me propozimet për shpërndarjen e fitimeve, i paraqesin këto dokumente përpara ortakut të vetëm që ushtron detyrat e Asamblesë së Përgjithshme për miratim;
- d) krijojnë një sistem paralajmërimi në kohën e duhur për rrethanat, që kërcënojnë mbarëvajtjen e veprimtarisë dhe ekzistencën e shoqërisë;
- dh) kryejnë regjistrimet dhe dërgojnë të dhënat e detyrueshme të shoqërisë, siç parashikohet në ligjin për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit;
- e) raporton përpara Asamblesë së Përgjithshme në lidhje me zbatimin e politikave tregëtare dhe me realizimin e veprimeve të posaçme me rëndësi të veçantë për veprimtarinë e shoqërisë tregtare;
- ë) kryen detyra të tjera të përcaktuara në ligj.

Në rastet e parashikuara nga statuti dhe në rastet e tjera te parashikuara në ligj, administratori është i detyruar të paraqese raport te ortakut i vetëm apo të thërrasë Asamblesë e Përgjithshme në rast se do të ketë shtim të ortakëve të shoqërisë.



Nëse Asambleja e Përgjithshme emëron më shumë se një administrator, ata e administrojnë bashkërisht shoqërinë.

Asambleja e Përgjithshme mund të shkarkojë administratorin në çdo kohë me shumicë të zakonshme.

Paditë, që lidhen me shpërblimin e administratorit, në bazë të marrëdhënieve kontraktore me shoqërinë, rregullohen sipas dispozitave ligjore në fuqi.

Administrator i shoqërisë është Z. Afrim Ismaili madhor, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, me nr.karte Identiteti nr.037063717, lindur ne Skrapar, me 20.03.1975 dhe banues ne, Tirane rruga Danish Jukniu , me afat emërimi për 5 vjet me të drejtë riemërimi.

## **LIBRAT E SHOQËRISË, BILANCI , DIVIDENTET**

### **NENI 18**

#### **LIBRAT E SHOQËRISË**

Shoqëria është e detyruar të mbajë përveç Librit të Shoqërisë, në të cilin shënohet emri i plotë i ortakut, kapitali themeltar, si dhe vendimet e ortakut të vetëm edhe dokumentacionin kontabël dhe librat e tjerë.

### **NENI 19**

#### **BILANCI**

Viti financiar fillon ne 1 Janar dhe përfundon me 31 Dhjetor të çdo viti.

Llogaritë vjetore, inventari, raportet mbi operacionet e vitit financiar dhe raportet e hartuara nga eksperti kontabël, miratohen nga ortaku i vetëm.

Miratimi i dokumentave mbi veprimtarinë vjetore bëhet brenda një afati prej 6 muajsh nga data e mbylljes së vitit financiar.

### **NENI 20**


#### **DIVIDENTET**

Pas miratimit të llogarive vjetore dhe duke theksuar ekzistencën e fitimeve, mbledhja e aksionarëve përcakton pjesën e anëtarëve në formën e dividendëve mbi fitimet, në përpjesëtim me përqindjen e pjesëmarrjes së secilit aksioner në kompani. Fitimet që do të shpërndahen midis anëtarëve në përpjesëtim me aksionet e kapitalit të kompanisë, përbëhen nga fitimi i vitit në të cilin janë zbritur shumat e rezervuara për fondin e domosdoshëm të aksioneve (5% të fitimeve) të secilit vit, derisa ky fond arrin vlerën 1/10 të kapitalit të kompanisë) dhe, nga ana tjetër, humbjet ose të ardhurat e mbajtura nga vitet e mëparshme zbriten ose rriten respektivisht.

## **MBARIMI DHE LIKUJDIMI I SHOQËRISË**

### **NENI 21**

#### **MBARIMI**





22.1 Shoqëria mbaron me vendim të ortakut të vetëm ose kur ka një prishje të parakohshme për arsyet e parashikuara në ligj.

**NENI 22  
LIKUJDIMI**

23.1 Shoqëria hyn në procesin e likujdimit që në momentin e prishjes së saj. Për kryerjen e këtij procesi ortaku cakton një ose disa likujdues, të cilët i paraqesin asaj raportin mbi gjendjen e aktivitetit dhe pasivitetit të Shoqërisë, mbi ndjekjen e operacioneve të likujdimit dhe mbi afatin e nevojshëm të përfundimit të tyre.

Në fund të procesit të likujdimit, ortakët vendosin mbi bilancin përfundimtar financiar dhe mbi mbylljen e procesit të likujdimit. Mbas pagimit të kreditorëve ortaku i vetëm mban pjesën e mbetur të kapitalit.

**MOSMARRËVESHJET DHE DISPOZITA E FUNDIT  
NENI 23  
ZGJIDHJA E MOSMARRËVESHJEVE**

Të gjitha mosmarrëveshjet që mund të lindin gjatë ekzistencës së Shoqërisë ose gjatë periudhës së likujdimit do t'i paraqiten për zgjidhje gjykatës kompetente shqiptare, pasi të jete ezauruar mundësia e zgjidhjes së mosmarrëveshjes me mirkuptim midis ortakëve.

**NENI 24  
DISPOZITA E FUNDIT**

Pasuria e Shoqërisë mund të sigurohet në ndonjë Institut Sigurimi si brenda ashtu edhe jashtë Shqipërisë.

Shoqëria do të ketë vulën e saj, forma dhe madhësia e së cilës do të përcaktohen nga Ortaket e shoqërisë.

Ky Statut është hartuar në 3 (tre) kopje, në gjuhën shqipe, duke patur secila fuqi të njëjtë ligjore.

Tirane, me 03.11.2021

**Ortaku i vetem**

**Francesco Bongiovanni**

